

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË BERAT

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Bashkinë Berat me objekt: “Mbi vlerësimin e aktivitetit ekonomik-financiar, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike, shesheve e lejeve të ndërtimit, lejeve të shfrytëzimit, administrimin e aseteve, shitjen e trojeve, dhënien me qira të objekteve pronë publike, funksionimi i policisë bashkiake, organizimin dhe funksionimin e njësive të auditimit, organizimin dhe funksionimin e inspektoratit urbanistik ndërtimor vendor etj” dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 6, datë 24.01.2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 257/9, datë 24.01.2012, dërguar z. **Fasil Nasufi**, Kryetar i Bashkisë, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE.

1. Të analizohet në këshillin bashkiak efekti financiar i krijuar në dëm të buxhetit të bashkisë, nga moszbatimi i ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, i ndryshuar, nenet 2, 7, 16, urdhrit të Kryeministrit nr. 70, datë 18.04.2006 “Për masat në zbatim të rekomandimeve të Kontrollit të Lartë të Shtetit, Auditit të Brendshëm dhe Departamentit të Kontrollit të Brendshëm Administrativ dhe Antikorrupsion, në Këshillin e Ministrave, në institucionet në varësi të Kryeministrit e të ministrive”, ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i procedurës administrative”, si dhe të dalë përgjegjësia për zhdëmtim material për vlerën **9.769.836 lekë**.

Menjëherë

2. Të mos jepen leje ndërtimi, pa përfunduar më parë plani territorial vendor nga autoritetet përkatëse të planifikimit, si dhe sigurohet që ai të përmbush standardet teknike e procedurale, të përcaktuara në zbatim të ligjit nr. 10119, datë 23.4.2009 “Për planifikimin e territorit”, të ndryshuar dhe të akteve nënligjore në funksion të tij.

Menjëherë.

3. Të zbatohen procedurat ligjore, për rishqyrtimin e statusit juridik të ndërmarrjes së gjelbërimit.

Menjëherë.

4. Për anëtarët e këshillit bashkiak të zbatohet statusi i këshilltarit, duke mos ushtruar edhe detyra të tjera administrative në aparatin e bashkisë ose në njësitë vartëse të saj, në papajtueshmëri të funksionit të këshilltarit dhe në konflikt interesi, në kundërshtim me ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 25, pika a, b, c, ç, ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”, neni 4, pika d.

Në vazhdimësi.

5. Në Ndërmarrjen Ekonomike të Arsimit, nga kryetari i bashkisë të autorizohet firmë e dytë firma e specialistes së financës, në zbatim të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për kontabilitetin

dhe pasqyrat financiare”, vendimit të këshillit të Ministrave nr. 783, datë 22.11.2006 “Për caktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”, si dhe të shkresës nr. 6153, datë 27.05.2009 të Ministrisë të financave “Për firmosjen e urdhër shpenzimit”.

6. Likuidimet e blerjeve me vlera të vogla të kryera nga njësitë vartëse: “Drejtoria Ekonomike e Arsimit” dhe “Njësia e Zbatimit të Projektit për Banesat Sociale”, të bëhen nga vetë ato, ose nga Drejtoria e Buxhetit dhe Administrimit Financiar, pasi të jetë kontrolluar i gjithë dokumentacioni justifikues.

Menjëherë.

7. Të zbatohen procedurat ligjore për inventarizimin dhe regjistrimin e Pasurisë së Paluajtshme të Bashkisë.

Menjëherë.

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Të kërkohet në rrugë ligjore **shuma prej 2.478.095 lekë**, e cila përbën dëm ekonomik për buxhetin e bashkisë, nga ku:

a. Shuma 764.597 lekë përfaqëson përfitim të padrejtë në prokurimet me fondet publike në një rast, përkatësisht nga shoqëria ■■■ Berat për objektin: “Rikonstruksion i rrugës 28 “Nëntori”, viti 2010.

Veprime në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, nenet 7, 8, 9, 11, 12, 14, UKM nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, UKM nr. 3 datë, 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, paragrafi I, pika 1, 3, 4, paragrafi II, pika 3, 7, dhe “Kushtet teknike të zbatimit”, paragrafi I, 5, 3.

Brenda datës 30.03.2012

b. Shuma 1.435.290 lekë përfaqëson detyrim të pa paguar gjatë marrjes së lejes së ndërtimit në 13 raste, në kundërshtim me ligjin nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për urbanistikën”, i ndryshuar, neni 51, ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave”, i ndryshuar, neni 27.

Brenda datës 30.03.2012

c. Shuma 193.491 lekë përfaqëson mos arkëtimin e qirasë dhe kamatëvonesat për mospagimin në afat të tyre në 10 raste, në kundërshtim me VKM nr. 1712, datë 24.12.2008 “Për dhënien me qira ose enfiteozë të pasurive shtetërore”, i ndryshuar, kreu VI.

Brenda datës 30.03.2012

d. Shuma 9.147 lekë përfaqëson pagesë të tepër ing. ■■■ në cilësinë e kolaudatorit në objektin “Rikonstruksion i rrugës Dake Berberi-Stadiumi i Ri” viti 2010, në kundërshtim me kërkesat e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 444, datë 05.09.1994 “Për tarifatat e studimit, projektimit, drejtimit dhe kolaudimit të veprave të ndërtimit”.

Brenda datës 30.03.2012e

Shuma 75.570 lekë përfaqëson vlerë të pa likuiduar të energjisë elektrike nga Televizioni Publik Shqiptar në vitin 2010, për përdorimin e Repetitorin “K” pronë e Bashkisë.

Brenda datës 30.03.2012

A. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 25 të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 "Statusi i nëpunësit civil" dhe pikën 1 e 2 VKM nr. 306, datë 13.06.2000 "Për disiplinimin në shërbimin civil", kryetari i bashkisë të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

a. "Largimi nga shërbimi civil", neni 25, pika 3, germa d:

1. ■ me detyrë drejtor i drejtorisë së urbanistikës për;

- kalimin në këshillin teknik dhe në KRRT-në e bashkisë të lejeve të ndërtimit bazuar në studimet urbanistike pjesore, të cilat janë hartuar dhe miratuar vetëm në fazën e projekt idesë dhe të projektit teknik, duke mos e shoqëruar edhe me projektin e zbatimit të rrjetit rrugor, planin e sistemit të kuotimit, rrjetin e infrastrukturës inxhinierike etj, në kundërshtim me rregulloren e urbanistikës të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 722, datë 19.11.1998, e ndryshuar.

- dhënie leje ndërtimi në zonë të gjelbër dhe në zona për shërbime publike, në kundërshtim me planin rregullues të qytetit të miratuar në vitin 1983 dhe ligjin nr. 8405, datë 17.09.1998 "Për urbanistikën", neni 62.

- mos respektimit të kondicioneve urbane në drejtim të distancës së objekteve, në kundërshtim me Rregulloren e Urbanistikës, të miratuar me VKM nr. 722, datë 19.11.1998, e ndryshuar.

- miratim leje ndërtimi me studim urbanistik pjesor për objekte që ndodhen jashtë vijës kufizuese të ndërtimit të qytetit, në kundërshtim me ligjin nr. 8405, datë 17.09.1998 "Për Urbanistikën", i ndryshuar, neni 9, neni 20 neni 32, si dhe "Rregulloren e Urbanistikës", të miratuar me VKM nr. 722, datë 19.11.1998, e ndryshuar, pika 52.

- miratim leje ndërtimi në zonën e lirë të qytetit, nga të cilat një leje me studim urbanistik pjesor dhe tre leje pa studim urbanistik pjesor, për banesa me lartësi mbi 5 kate, veprim në kundërshtim me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 826, datë 28.12.2005 Për shpalljen "Qendër Historike" të një zone në qytetin-muze të Beratit dhe miratimin e rregullores së administrimit të kësaj Qendre, neni 6, pika c.

- pranimin e plan rievimeve si planimetri kadastrale dhe jo relieve topografike të pa bazuar në rrjetin kordinativ shtetëror, në kundërshtim me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 110, datë 17.05.1984, vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 332, datë 12.03.2008 "Për përcaktimin e rregullave të përgjithshme për ruajtjen dhe administrimin e informacionit hartografik, përfituar nga fotografimi ajror, digjital, i territorit të Republikës së Shqipërisë", ligjin nr. 8405, datë 17.09.1998 "Për Urbanistikën", i ndryshuar dhe "Rregulloren e Urbanistikës" të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 722, datë 19.11.1998, e ndryshuar.

Menjëherë

b. "Kalim në një detyrë të një niveli apo klase më të ulët për një për 1 vit", neni 25, pika 3, germa ç:

1. ■ me detyrë përgjegjës i njësisë së auditimit për;

- mos pajisje me certifikatën e auditit të brendshëm në sektorin publik, në kundërshtim me ligjin nr. 9720, datë 23.04.2007 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik", i ndryshuar me ligjin nr. 10318, datë 16.09.2010, neni 13 citon në mënyrë eksplicite " Në nenin 19, shkronja "c" të pikës 2 të ndryshohen si më poshtë;

c "kandidatët e përzgjedhur për pozicionin drejtor të njësisë së auditimit të brendshëm", duhet të jenë të pajisur me dëshminë "Auditues i brendshëm në sektorin publik" dhe të kenë përvojë pune 5-vjeçare si auditues".

- tejkalim të kompetencave ligjore duke kontrolluar shoqëri tregtare, konkretisht shoqërinë “S” sh.p.k. Berat dhe Shoqërinë ██████ sh.p.k. Berat, në kundërshtim me ligjin nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për auditin e brendshëm në sektorin publik, i ndryshuar me ligjin nr. 10318, datë 23.04.2007, ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me nr. 10137, datë 11.05.2009, nr. 10148, datë 28.09.2009, nr. 10260, datë 1.04.2010 dhe ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

- kryerje dhe firmosje rezultat auditimi i pa pajisur me dëshminë “Auditues i brendshëm në sektorin publik”, si dhe fshehje profesionale (nuk ka pasqyruar saktë realitetin), konkretisht;

- në Ndërmarrjen e Gjelbërimit, në kundërshtim me ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nenet 6,7,111,112,113, ligjin nr.9471, datë 29.04.1991 “Për ndërmarrjet shtetërore”, i ndryshuar nenet 1,2,3,4,5,8,9,10,17,18,19,20,23,24, ligjin nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Qeverisjes Vendore”, neni 32.

- për gjashtë anëtarë të këshillit bashkiak, të cilët kanë qenë emërtesë e kryetarit të bashkisë, duke ushtruar edhe detyra të tjera administrative në aparatin e bashkisë ose në njësitë vartëse të saj, **në papajtueshmëri të funksionit të këshilltarit dhe konflikt interesi**, në kundërshtim me ligjin nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, neni 25, pika a, b, c, ç, ligjin nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksioneve publike”, neni 4, pika d.

Menjëherë.

2. Znj. ██████ me detyrë drejtorisë buxhetit dhe administrimit financiar për;

- mos zbatimin e rekomandimeve të KLSH-së të dërguar me shkresën nr. 652/12, datë 28.07.2010.

Menjëherë.

c. “Vërejtje me paralajmërim”, neni 25, pika 3, germa b, për:

1. Znj. ██████ me detyrë specialiste e sekretarisë teknike në drejtorinë e urbanistikës dhe planifikimit të territorit për;

- mungesë të projekteve të ruajtjes së nxehtësisë në ndërtesa, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 8937, datë 12.09.2002 “Për ruajtjen e nxehtësisë në ndërtesa”, V. K. M nr. 584, datë 02.11.2000 “Për kursimin e energjisë dhe ruajtjen e ngrohtësisë në ndërtime”, V. K. M nr. 38, datë 16.01.2003 “Për miratimin e normave, të rregullave dhe kushteve të projektimit dhe të ndërtimit, të prodhimit dhe ruajtjes së nxehtësisë në ndërtesa” dhe ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, neni 4.

- mungesë të projekteve për personat me aftësi të kufizuar, veprim në kundërshtim me VKM nr. 1503, datë 19.11.2008 për miratimin e Rregullores “Për shfrytëzimin e hapësirave nga personat me aftësi të kufizuar”.

- mungesë të deklaratave të posaçme nga projektuesit përkatës, me anën e të cilave duhet të deklarohen se projektet konstruktiv dhe të instalimeve elektrike dhe hidrosanitare, janë hartuar në përputhje me të gjitha normat teknike në fuqi, në zbatim të ligjit nr. 10078, datë 16.02.2009 Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për Urbanistikën”, të ndryshuar.

- në 2 raste formularët për miratimin e lejes së ndërtimit, janë dhënë pa lidhur më parë kontratën ndërmjet subjektit ndërtues dhe mbikëqyrësit të punimeve të ndërtimit, veprim në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, ligjin nr. 7850, datë 29.07.94 “Për kodin civil të Republikës së Shqipërisë”, neni 659, 676 691, 693 dhe udhëzimet e Këshillit të Ministrave nr. 2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” dhe nr. 3, datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”.

Menjëherë.

2. Z. ■ me detyrë jurist i drejtorisë së urbanistikës dhe planifikimit të territorit për;

- Mos pasqyrim në procesverbalet e mbledhjeve të KRRT të deklaratave të anëtarëve të KRRT-së për të mos u përfshirë në votim, në rastet kur kalojnë për miratim projektet e tyre, në kundërshtim me ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”. Për pasojë nuk mund të gjykohet sa ndikim ka pasur vota e anëtarëve të KRRT me konfliktet e mundshme të interesit në vendimmarrjen e KRRT.

-Me vendim nr. 9, datë 26.04.2008 është dhënë leje ndërtimi, me objekt “Dy banesa me qëllim social”, me sipërmarrës shoqërinë ■ sh.p.k. Berat, me drejtues ligjor B. Z. i cili është njëkohësisht dhe anëtar i këshillit bashkiak, në kundërshtim me ligjin nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

Menjëherë.

3. Z. ■ me detyrë specialist i kadastrës urbane i drejtorisë së urbanistikës dhe planifikimit të territorit për;

- pranimin e plan rievimeve si planimetri kadastrale dhe jo reliev topografike të pa bazuar në rrjetin koordinativ shtetëror, në kundërshtim me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 110, datë 17.05.1984, vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 332, datë 12.03.2008 “Për përcaktimin e rregullave të përgjithshme për ruajtjen dhe administrimin e informacionit hartografik, përfituar nga fotografimi ajror, digjital, i territorit të Republikës së Shqipërisë”, ligjin nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për Urbanistikën”, i ndryshuar dhe “Rregulloren e Urbanistikës” të miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave nr. 722, datë 19.11.1998, e ndryshuar.

Menjëherë.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Fatmir Iliazi, Agim Shehu, Josif Lile, Fatos Doda dhe Tatjana Shurbi. Më tej u shqyrtua nga Kryeaudituesi i Departamentit Miranda Haxhia, Drejtori i Departamentit Osman Alushi, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Elvana Tivari, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm Robert Gjini.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT